



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MEDHA

VENDIM

Nr 3 Datë 28.6.2019

Për

**Shqyrtimin e miratimin e dy projekteve “Rehabilitimin e digës së ujëmbledhësit Arapaj-1”
dhe “Rehabilitimin e shkarkuesit katastrofik së ujëmbledhësit Spitallë”**

Në zbatim të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, nenit 9 si dhe “Regullores për sigurinë e digave dhe dambave” Neni 13 Riparimet, të miratuar me VKM nr. 147, datë 18.03.2004, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në mbledhjen e tij të datës 28.06.2019, mori në shqyrtim materialin e arrdhur nga Bashkia Durrës në lidhje me dy projektet e zbatimit “Rehabilitimin e shkarkuesit katastrofik së ujëmbledhësit Spitalë” dhe “Rehabilitimin e digës së ujëmbledhësit Arapaj-1”. Projektet janë hartuar nga firma projektuese “Gramë” shpk. Materiali u prezantua nga përfaqësuesit e firmës “Gramë” shpk, ing. Ariola Mazari.

Rezervuari i Spitallës

Diga është ndërtuar në vitin 1968 ka një lartësi 14.9m gjatësi kurore 215m, homogjene me vëllim rrëth 388000 m³. Ujëlëshuesi i digës është i bllokuar prej vitesh. Në shkarkues janë bërë ndërhyrje të ndryshme rastësore e të pa miratuara.

Poshtë digës janë ndërtuar disa dhjetra shtëpi private.

Projekti që paraqitet tenton të trajtojë disa problematikat, si nivelimin e kurorës, korigjimin e shkarkuesit dhe kontrollin e ujëlëshuesit ekzistues e cbllokimin e tij.

Për sa më sipër si dhe të faktit që:

- Digat e këtij lloji kanë qenë ndërtuar për një periudhë deri 30 vjecare.
- Ujëlëshuesi është i bllokuar dhe nuk kemi asnje të dhënë si për gjëndjen e tij, ashtu dhe për mbushjen me aluvione të kupës së rezervuarit.
- Nuk kemi kurbën e volumeve të ujit të kupës së rezervuarit për të gjykuar për të ardhmen e leverdinë në investim.
- Duhet të rishikohen llogaritjet hidrologjike për të marrë në konsideratë stacionin hidrometeorologjik të Durrsit, si stacioni më i afërt.
- Nuk kemi të dokumentuara ndryshimet në shkarkuesin katastrofik.

Rezervuari Arapaj nr.1

Rezervuari Arapaj nr.1 është ndërtuar në vitin 1970. Diga ka lartësi 6.3 m dhe gjatësi në kurorë 109 m.

Në anën e djathtë të digës vërehet një rrëshqitje me front rrëth 30 m.

Ujëlëshuesi është i bllokuar.

Në projekt parashikohet ndërtimi i një shkarkuesi të ri me kapacitet $16\text{m}^3/\text{sek}$ për prurjen me siguri 1%

Mbas paraqitjes së dy projekteve nga firma “Grama” projektuesja ing. Ariola Mazari, paraqitjes së rekomandimeve të Këshillit Teknik, pyetjeve e diskutimeve nga të gjithë anëtarët e Komitetit, KKDM:

V E N D O S I

Për rezervuarin e Spitalës

1. Është me interes që si hap i parë të bëhet cbllokimi i ujëlëshuesi ekzistues, për të bërë të mundur vlerësimin e gjëndjes lidhur me mbushjen me aluvione të kupës së rezervuarit, gjëndjen e ujëlëshuesit apo mundësinë e ndërtimit të një të riu si dhe leverdinë e prespektivës.
2. Në vijim të pikës 1, të rillogariten prurjet e shkarkimit me rreshjet e stacionit të Durrësit dhe të bëhet rivlerësimi dhe ridimesionimi i shkarkuesit katastrofik.
3. Në këto punime të parashikohet dhe pastrami i skarpatave të digës dhe të bëhet një vlerësim gjeologjik i gjëndjes së saj dhe sidomos anës së poshtme.
4. Bashkia Durrës duhet që urgjentisht të largojë të gjitha pengesat që mund të jenë krijuar në shkarkuesin katastrofik krahasuar me projektin fillestar.

Për rezervuarin Arapaj nr.1

1. Të bëhet cbllokimi i ujëlëshuesit për të bë të mundur vlersimin për gjendjen e mbushjes së kupës me aluvione
2. Të bëhet studimi gjeologjik për rrëshqitjen dhe llogaritë e qëndrushmërisë së digës e bazamentit të saj.
3. Të rishikohen llogaritjet hidrologjike me stacionin e Xhafzotajt si më i afërt
4. Të rishikohet dhe rikostrucionohet shkarkuesi për prurjet që do të rezultojnë.

Inxh. Maksim Muci

K R Y E T A R

